

1. Informacion i përgjithshëm

Universiteti Polis shpk është krijuar më 30/03/2006 me nr. Vendimi 35386 date 04/04/2006.

Misioni i Shoqërisë është themelimi i Shkollës Ndërkombëtare të Arkitekturës dhe Politikave të Zhvillimit Urban, e cila përbëhet nga Fakulteti i Arkitekturës dhe Dizanjit dhe Fakulteti i Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban.

NIPT-i i Shoqërisë është K623080085. Selia e shoqërisë ndodhet në autostradën Tiranë-Durrës, km 5 Kashar, Tiranë.

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 Lekë dhe zotërohet nga ortaket:

- Dritan Shutina 25% të kuotave
- Gazmend Haxhia 25% të kuotave
- Besnik Aliaj dhe 25% të kuotave
- Sotir Dhamo 25% të kuotave

Në 31 dhjetor 2018 shoqëria ka 129 punonjës. (2017: 98 punonjës)

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:



2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5. Vlerësime dhe gjykime(vazhdim)

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
EUR/Lek	123.42	132.95
USD/ Lek	107.82	111.10



3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuara duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuara duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuara sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.



3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlërësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlërësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlërësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlërësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlërësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlërësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlërësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivitetet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlërësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.



3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2018 dhe 2017 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndërtesa, instalime	Vlera e mbetur	5%
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Mobilje zyre	Vlera e mbetur	20%
AAJM	Vlera fillestare	15%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative.



3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i prituri për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2018 është 15% (2017: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për llogaritjen e tatimit të shtyrë mbi fitimin.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.



3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.13. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Mjete monetare në bankë	26,058,825	19,216,808
Në Lekë	1,119,374	251,945
Në monedhë të huaj	24,939,451	18,964,863
Mjete monetare në arkë	620,821	1,300,166
Në Lekë	545,071	1,300,166
Në monedhë të huaj	75,750	-
	<u>26,679,646</u>	<u>20,516,974</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Klientë për mallra dhe shërbime	5,354,232	5,065,687
	<u>5,354,232</u>	<u>5,065,687</u>

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Motown sh.p.k	3,983,894	1,967,594
Metropolis sh.p.k	1,820,617	2,262,619
	<u>5,804,511</u>	<u>4,230,213</u>



Universiteti Polis sh.p.k.
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
 (Vlerat janë në Lekë)

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Të tjera llogari të arkëtueshme më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Tatim fitimi	-	433,841
Debitorë të ndryshëm	437,645	-
	<u>437,645</u>	<u>433,841</u>

8. Inventari

Inventari më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Mallra (Libra)	3,259,838	3,186,004
	<u>3,259,838</u>	<u>3,186,004</u>

9. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Shpenzime të periudhave të ardhshme	8,852,318	6,285,432
	<u>8,852,318</u>	<u>6,285,432</u>



Universiteti Polis sh.p.k.
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(Vlerat janë në Lekë)

10. Aktive afatgjata materiale

Kosto	Ndërtesa	Makineri dhe Pajisje	Mjete transporti	Pajisje informatike	Mobilje e pajisje zyre	Të tjera	Totali
Gjendja më 1 janar 2017	58,199,364	23,299,849	662,500	27,791,665	32,474,980	15,724,481	158,152,839
Shtesa				7,037,847	4,110,004	56,212	11,204,063
Gjendja më 31 dhjetor 2017	58,199,364	23,299,849	662,500	34,829,512	36,584,984	15,780,693	169,356,902
Shtesa		1,068,954			2,263,575	125,436	3,457,965
Pakësime							-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	58,199,364	24,368,803	662,500	34,829,512	38,848,559	15,906,129	172,814,867
Amortizimi i akumuluar							
Gjendja më 1 janar 2017	15,511,429	10,663,817	537,458	21,598,827	23,724,268	6,071,207	78,107,006
Amortizimi i vitit	2,134,397	2,527,007	25,009	2,576,672	1,915,879	556,163	9,735,127
Gjendja më 31 dhjetor 2017	17,645,826	13,190,824	562,467	24,175,499	25,640,147	6,627,370	87,842,133
Amortizimi i vitit	2,027,677	2,178,334	20,007	2,771,306	2,210,063	472,664	9,680,051
Pakësime							-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	19,673,503	15,369,158	582,474	26,946,805	27,850,210	7,100,034	97,522,184
Vlera neto kontabël							
Gjendja më 31 dhjetor 2017	40,553,538	10,109,025	100,033	10,654,013	10,944,837	9,153,323	81,514,769
Gjendja më 31 dhjetor 2018	38,525,861	8,999,645	80,026	7,882,707	10,998,349	8,806,095	75,292,683



Universiteti Polis sh.p.k.
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
 (Vlerat janë në Lekë)

11. Aktivet afatgjata jomateriale

Aktivitet afatgjata jomateriale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	AAJM	Total
Me kosto		
Gjendja më 1 janar 2017	1,684,487	1,684,487
Shtesa		-
Pakësime		-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	1,684,487	1,684,487
Shtesa		-
Pakësime		-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	1,684,487	1,684,487
Zhvlerësimi akumuluar		
Gjendja më 1 janar 2017	105,280	105,280
Zhvlerësimi i vitit	252,673	252,673
Pakësime		-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	357,953	357,953
Zhvlerësimi i vitit	252,673	252,673
Pakësime		-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	610,626	610,626
Gjendja neto më 31 dhjetor 2017	1,326,534	1,326,534
Gjendja neto më 31 dhjetor 2018	1,073,861	1,073,861

12. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Furnitorë	1,548,704	2,420,981
Furnitorë për fatura të pambërritura	449,441	366,331
	1,998,145	2,787,312



Universiteti Polis sh.p.k.
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
 (Vlerat janë në Lekë)

13. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Tatim në burim	182,486	70,602
Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	2,388,989	2,102,844
Tatimin mbi të ardhurat personale	1,041,082	939,652
TVSH për t'u paguar	14,209	257,017
Detyrime për tatimin mbi fitimin	1,863,589	-
	5,490,355	3,370,115

14. Granted he të ardhura të shtyra

Grante për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Të ardhura të periudhave të ardhshme	42,983,528	43,903,907
Grante afatshkurtër të përfituara nga projektet	661,204	-
	43,644,732	43,903,907

15. Të tjera detyrime

Të tjera detyrime për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Paga për t'u paguar	1,174,955	669,621
Të tjera detyrime	-	1,526,517
	1,174,955	2,196,138

16. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Detyrime afatgjata ndaj ortakëve	39,114,840	40,604,099
	39,114,840	40,604,099



17. Grante dhe të ardhura të shtyra

Grante dhe të ardhura të shtyra për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Grante për aktivet afatgjata materiale	19,607,150	3,047,512
Grante për aktivet afatgjata materiale për projektet	-	18,718,904
	19,607,150	21,766,416

Të ardhurat e shtyra përfaqësojnë parapagimet e bëra nga studentët për vitin akademik 2018-2019, të derdhura në llogarinë bankare. Këto shuma nuk përfaqësojnë flukse dalëse në periudha afatshkurtra. Për fondet e hyra shoqëria ka prerë faturë tatimore, por nuk ka përfshirë në të ardhura të vitit 2018 pjesën që i takon semestrit të parë që mbyllet në shkurt 2019. Lëvizjet e këtij grupi sqarohen në rakordimin e të ardhurave për efekt të rakordimit me TVSH (Shtesë e këtyre shënimeve).

18. Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100,000 Lekë. 25 kuota zotërohen nga ortaku Dritan Shutina, 25 kuota nga ortaku Gazmend Haxhia, 25 kuota nga ortaku Besnik Aliaj dhe 25 kuota zotërohen nga ortaku Sotir Dhamo:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Numri i kuotave	100	100
Vlera nominale (në Lek)	1,000	1,000
Kapitali	100,000	100,000

Fitimi i mbartur për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 ishte 7,831,467 ALL. (2017: 3,190,113 ALL)

Fitimi i ushtrimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 ishte 7,793,090 ALL. (2017: 4,641,354 ALL)

19. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga tarifat shkollore	221,173,553	191,798,183
	221,173,553	191,798,183



20. Të ardhurat e tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga nën-qeraja	2,291,550	2,414,400
Të ardhura nga grantet	11,181,113	14,253,765
Të ardhura nga kancelaria dhe aktivitetet	1,897,366	2,882,251
Të ardhura të tjera	5,192,744	15,773,106
Te ardhura nga kompensimi detyrimeve tatimore	-	6,643,725
Shpenzimet nga këmbimet valutore për marrëdhëniet tregtare neto	(2,240,729)	13,484
	18,322,044	41,980,731

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së.

	31 dhjetor 2018
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Qarkullim i tatueshëm	238,952,266
Shtohen parapagimet në çelje	43,903,907
Zbriten parapagimet në mbyllje	(42,983,528)
Ndryshimi në grante	1,498,062
Efekt i kurseve te kembimit	(2,240,729)
Falje detyrimi	365,619
Shuma e qarkullimit e korrektuar	239,495,597
Sipas Kontabilitetit	239,495,597
Diferenca	-

Universiteti Polis sh.p.k.
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
 (Vlerat janë në Lekë)

21. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shpenzime qeraje	45,687,600	48,389,400
Blerje energji, avull, ujë karburant	3,919,400	3,726,650
Kancelari dhe botime	2,136,254	2,253,720
Shpenzime internet	307,184	1,377,584
Shpenzime transporti	993,043	1,076,400
Konsulence	1,123,294	57,600
Konferenca dhe projekte	14,657,373	15,239,821
Honorare	7,540,327	4,930,930
Shpenzime reklame	1,783,646	1,500,351
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	521,068	416,921
Mirembajtje dhe riparime	463,618	564,514
Shpenzime pastrimi	886,274	746,498
Shërbime bankare	389,702	673,032
Shpenzime te tjera	5,250,493	9,823,978
Tatime dhe taksa	474,200	474,200
	86,133,476	91,251,599

22. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shpenzime paga	117,766,680	113,028,323
Shpenzime për sigurime shoqërore	15,504,061	14,215,821
	133,270,741	127,244,144

23. Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi

Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shpenzime amortizimi	9,932,724	9,987,800
	9,932,724	9,987,800



24. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit, ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shpenzime për interesa	68,136	280,646
	68,136	280,646

25. Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Fitimi para tatimit	10,090,520	5,014,725
Total shpenzime të panjohura	5,225,680	258,239
Shpenzime të tjera	5,225,680	4,918,879
Të ardhura të patatueshme nga kompensimi i detyrimeve tatimore		(4,660,640)
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	15,316,200	5,272,964
Humbje fiskale e mbartur		(2,783,827)
Fitimi i tatueshëm	15,316,200	2,489,137
Tatim fitimi @15%	2,297,430	373,371
	7,793,090	4,641,354

26. Transaksionet me palët e lidhura

Transaksionet me palët e lidhura gjate vitit 2018 dhe 2017 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2018		31 dhjetor 2017	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Motown sh.p.k	3,983,894		1,967,594	
Metropolis sh.p.k	1,820,617		2,262,619	
	5,804,511	-	4,230,213	-

	31 dhjetor 2018		31 dhjetor 2017	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Motown sh.p.k	1,527,700	286,500	1,609,600	1,428,485
Metropolis sh.p.k	657,865	2,486,600	1,105,555	
	2,185,565	2,773,100	2,715,155	1,428,485



Universiteti Polis sh.p.k.
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(Vlerat janë në Lekë)

27. Angazhime dhe pasiguri

Angazhimet për qera operative paraqiten me poshte:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Për t'u paguar deri në 1 vit	44,431,200	47,862,000
Për t'u paguar deri në 5 vjet	33,323,400	83,758,500
	77,754,600	131,620,500

28. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.



Shkolla Ndërkombëtare e Arkitekturës
UNIVERSITETI
POLIS